



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ  
Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT  
**O M B U D S M A N**  
Republic of Macedonia

Më datë 19.07.2017, Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizitë të rregullt të paparalajmëruar në Stacionin Policor me Kompetencë të Përgjithshme - Manastir, e cila filloi në ora 10:30, ndërsa përfundoi në ora 13:30. Paraprakisht, nga ana e ekipit të MPN-së ky stacion policor ishte vizituar më datë 06.06.2013.

Vizita buron nga mandati i Avokatit të Popullit - Mekanizmi Parandalues Nacional, i parashikuar me Protokollin Fakultativ ndaj Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Johumane, Nënçmuese ose Ndëshkuese. Me Protokollin Fakultativ përkufizohet se MPN-ja realizon vizita të rregullta në vendet ku personat privohen nga liria, me qëllim të identifikimit të rreziqeve për shkak të parandalimit të torturës ose llojeve tjera të trajtimeve brutale, jonjerëzore, nënçmuese ose ndëshkuese.

Ekipi i MPN-së hasi në bashkëpunim të mirë nga ana e personave zyrtarë të punësuar në Stacionin policor Manastir, të cilët mundësuan qasje papengesë deri te të gjitha hapësirat dhe instalimet dhe këqyrje mbi dokumentacionin e kërkuar.

Gjatë vizitës së Stacionit policor u konstatua se në hyje të të njëjtit ka rampë për qasjen e personave me aftësi të kufizuar fizike, me çka këtyre personave u mundësohet qasje papengesë deri te shërbimi kujdestar dhe zyrat e nëpunësve në Stacionin policor Manastir. Është vendosur edhe sënduk për paraqitjen e parashtresave nga qytetarët deri te Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale, deri te të cilët mundësi për këqyrje kanë vetëm personat zyrtarë të këtij Sektori.

Gjatë këqyrjes së realizuar në zyrat e nëpunësve dhe hapësirat e tjera, ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional, nuk vërejtí mjetet, e as sende të tjera të dyshimta me të cilat do të mund të kryhej frikësimi mbi personat e arrestuar, përkatësisht personat e privuar nga liria dhe personat e ndaluar.

Stacioni policor nuk ka në dispozicion hapësira për marrje në pyetje, ndërsa bisedat dhe hetimet për personat e thirrur, të arrestuar, përkatësisht personat e privuar nga liria dhe personat e ndaluar, përveç në zyrën e udhëheqësit të turnit, zhvillohen edhe në zyrat e inspektorëve të krim policisë.

Stacioni policor nuk disponon me hapësirë të posaçme për ndalimin eventual të personave të mitur, megjithatë, nga këqyrja e kushteve materiale, në pjesën përdhese të kësaj ndërtese, ekziston hapësirë për personat e mitur, në të cilën zhvillohen biseda dhe bëhet pranimi i personave të mitur. Mekanizmi Parandalues Nacional konstatoi se SP Manastir i plotëson kushtet lidhur me hapësirën e posaçme për biseda me personat e mitur, të parashikuara me Ligjin për drejtësinë e fëmijëve.

Konform Aktvendimit për përcaktimin e stacioneve policore për ndalimin e personave, ky Stacion policor është caktuar si stacion policor në të cilin mund të zbatohet ndalimi, megjithatë, i njëjti nuk i përmbush standardet minimale vendore dhe ndërkombëtare për ndalimin e personave të privuar nga liria. I njëjti disponon me 3 hapësira për ndalimin e personave të cilat gjenden në pjesën

e bodrumit dhe në secilën prej tyre njëkohësisht mund të ndalohen më së shumti dy persona. Gjatë këqyrjes së realizuar në hapësirat e ndalimit, u konstatua se të njëjtat janë në rregull dhe të pastra me mure të bojatisur, dhe në secilën prej tyre kishte krevat, të pajisur me dyshek, shtroje, batanije dhe jastëk, ndërkaq, gjithashtu, me donacione është siguruar edhe tavolina me karrige, të cilat janë përforcuar për dysheme.

Nga biseda me udhëheqësin e turnit të Stacionit policor, Mekanizmi Parandalues Nacional u informua se personat çdoherë dhe menjëherë njoftohen me shkaqet e privimit të tyre nga liria, në gjuhën të cilën e kuptojnë. Përkatësisht, të arrestuarit, personat e privuar nga liria dhe personat e ndaluar, në Stacionin policor njoftohen për të drejtën e thirrjes së mbrojtësit, për ta njoftuar personin e tretë për arrestimin e tyre, përkatësisht privimin nga liria ose ndalimin, si dhe për të drejtën të kërkojnë ndihmë mjekësore, me ç'rast plotësohen edhe formularë përkatës.

Sipas informacioneve të pranura nga personat zyrtarë, për personat të cilët kanë lëndime evidente, por edhe për personat të cilët kërkojnë të ekzaminohen nga mjekut, thirret mjeku ose personi dërgohet në qendrën mjekësore, ndërsa për ofrimin e ndihmës mjekësore përpilohet shënim zyrtar.

Mekanizmi Parandalues Nacional konstatoi se në asnjërën nga hapësirat, në të cilat zhvillohen bisedat me të arrestuarit, përkatësisht personat e privuar nga liria dhe personat e ndaluar, nuk është instaluar sistemi për audio/video monitorim dhe, në këtë kuptim, me qëllim të parandalimit të torturës ose veprimeve tjera jopërkatëse me të arrestuarit ose me personat e privuar nga liria, gjatë kohës së hetimit, rekomandon që hapësirat në të cilat bëhet hetimi i këtyre personave të pajisen me mjete për audio dhe video mbikëqyrje.

Stacioni policor nuk disponon me buxhet të veçantë për ushqimin e personave të arrestuar, përkatësisht personat e privuar nga liria dhe personat e ndaluar, në përputhje me Procedurat Standarde Operative për trajtimin e personave të ndaluar në të cilat parashikohet që personave të ndaluar mbi 6 orë u takon një vakt, kështu që personat e privuar nga liria dhe personat e ndaluar, këtë vakt më së shpeshti e sigurojnë nga mjetet e tyre ose nga mjetet e nëpunësve policorë.

Me qëllim të sigurimit të informatave për aktivitetet e ndërmarra, si dhe për trajtimin e nëpunësve policorë me të arrestuarit, personat e privuar nga liria dhe personat e ndaluar, Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi këqyrje edhe në evidencën e përgjithshme e cila mbahet në këtë Stacion Policor.

Nga këqyrja në **Regjistrin për personat e arrestuar dhe Regjistrin për personat e privuar nga liria dhe personat e ndaluar**, MPN-ja konstatoi se nuk janë përmbushur të gjitha rubrikat dhe mungon evidentimi më i azhurnuar dhe i harmonizuar i të dhënave dhe ngjarjeve në regjistrat dhe dosjet e veçanta.

Siç mund të shihet nga regjistrat dhe dosjet, personat e arrestuar, personat e privuar nga liria dhe personat e ndaluar, njoftohen në kohë me të drejtat e tyre dhe respektohen të drejtat që ta njoftojnë personin e tretë për ndalimin e tyre, të thirrin mbrojtës ose, të kërkojnë ndihmë mjekësore. Në njëërën nga dosjet, në të cilat Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi këqyrje, bëhej fjalë për person të ndaluar – shtetas të huaj, me ç'rast në dosje kishte edhe deklarament/bisedë me personin e ndaluar përmes përkthyesit të autorizuar dhe nënshkrim nga përkthyesi i angazhuar. Për të njëjtin, në mënyrë përkatëse, ishte njoftuar edhe Ministri i Punëve të Brendshme dhe është respektuar procedura e plotë e trajtimit të shtetasit të huaj.

MPN-ja konstatoi se në rastet kur një person i ndaluar shpreh nevojën për mjek, është thirrur edhe ndihma e parë për shkak të gjendjes evidente të alkoolizimit dhe në procesverbalin për ndalimin e personave e njëjta është evidentuar. Në përbërje të lëndës ka shënim zyrtar për thirrje dhe sugjerim për ndihmë mjekësore, për çka MPN-ja konsideron se është pozitiv dhe duhet të shfrytëzohet si praktikë e mirë.

Si rezultat i vizitës së realizuar për rikontroll, Mekanizmi Parandalues Nacional përpiloi raport në të cilin i konstatoi gjendjet dhe dha rekomandime të cilat ia dërgoi Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Stacionit policor, me qëllim që të eliminohen mangësitë dhe rreziqet.